

Tiranë më 29.05.2025

KËRKESË ANKIMORE

Ankues: Mimoza Hajdarmataj, e bija e Mani, lindur me 09.01.1969 në Tropojë, kandidate nga lista shumë-emërore e Partisë Demokratike/Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD-ASHM).

Lënda:

- Kundërshtimi i vendimit nr.1326 datë 24.05.2025 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”;
- Rinumerimin dhe/ose rivlerësimi i votave në të gjitha KZAZ-t e Qarkut Trianë;
- Ndryshimi i rezultatit të tabelave përmbledhëse pas rinumerimit dhe/ose rivlerësimit të votave.

Drejtuar: Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Të nderuar!

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1326 datë 24.05.2025 ka miratuar tabelat përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Bashkëngjitur këtij vendimi në tabelën përmbledhëse të rezultatit për subjektin tonë zgjedhor rezulton se une, Mimoza Hajdarmataj kam marrë 5233 vota si kandidat i listës së hapur.

Gjatë procesit të verifikimit nga ana ime, kam vërejtur disa parregullsi të cilat mund të ndikojnë në ndryshimin e rezultatit në mënyrë tejet të ndjeshme, për sa i përket renditjes time në tabelën e kandidatëve.

Në këto kushte po paraqes këtë ankim pranë KAS, bazuar në dispozitat e mëposhtme të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë:

- Neni 124 pika 1: Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë kërkesë ankimore për veprimet ose mosveprimet e KZAZ-së.
- Neni 125: Kërkesa ankimore duhet të përmbajë faktet, provat dhe argumentet ligjore për të justifikuar kërkesën për ndryshim ose shfuqizim të vendimit të ankimuar.

- Neni 126 pika 1: KAS ka kompetencën të shqyrtojë kërkesat që lidhen me procesin e numërimit dhe përcaktimin e rezultateve për kandidatët.

- Neni 139 pika 1 dhe 2: Lejon rinumërimin e votave nëse ka indicie të arsyeshme se rezultati i shpallur nuk përputhet me vullnetin real të zgjedhësve dhe/ose ka dyshime për pavlefshmëri të padrejtë të votave.

Duke u bazuar në kqyrjet e deritanishme rezulton se me një parregullsi në masën mbi 1000 vota, ne te pakten 6 KZAZ (ZAZ 27, 28,32, 36, 41,43),

Nga kqyrjet e deritanishme rezulton se rezultati ne QV-t e meposhtme jane te ndryshme nga ato te rezultatit te miratuar:

1. 1500/00
2. 1709/00
3. 1718/00
4. 1739/01
5. 1739/00
6. 1740/00
7. 1740/01
8. 1741/00
9. 1741/01
10. 1741/02
11. 1742/00
12. 1742/01
13. 1746/00
14. 1746/01
15. 1747/00
16. 1747/01
17. 2032/00
18. 2031/00
19. 2023/04
20. 2024/00
21. 2024/01
22. 2025/00
23. 2025/01
24. 2014/02
25. 2014/01
26. 2014/00
27. 2011/01



- 28. 2022/01
- 29. 2022/00
- 30. 2017/02
- 31. 1577/02
- 32. 1574/00
- 33. 1565/00
- 34. 1565/01

Qendrat e Votimit te mesiperme, por edhe shume te tjera, krijojne bindjen se numerimi ka patur problematika ne te gjithe Qarkun e Tiranës, duke krijuar shkak per rinumerimin dhe/ose rivleresimin te te gjithave Qendrave te Votmit.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme përfundimisht,

KËRKOJ:

- Rinumerimin dhe/ose rivleresimin e te gjitha Qendrave te Votimit te Qarkut Tirane;
- Ndryshimin e Tabeles Permbledhese sipas rinumerimit dhe/ose rivleresimit te votave.

Me respekt,

Mimoza Hajdarmanaj

Kandidate për Deputetë – Qarku Tiranë

+355672083581